



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 21. 01. 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Çerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova dhe Ismet Beqiri.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Margarita K. Ukelli-deputete, Gurjeta Zeka-VV, Lumnije Murati - ZPRK, Sanije Berisha-OSBE, Bashmir Xhemaj e Valon Berisha - KPJ, Argjend Zejnaj - GP/AAK dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 dhjetor 2014;
3. Shqyrtimi i draft-planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Formimi i grupeve të miqësisë;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 dhjetor 2014

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26 dhjetor 2014.

3. Shqyrtimi i draft- planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2015

Enver Hoxhaj, theksoi se anëtarëve të Komisionit i është shpërndarë nga stafi një draft i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2015, i cili mund të shërbejë si bazë për propozime, plotësime dhe ndryshime të tij nga anëtarët e Komisionit. Në këtë draft-plan janë paraparë: raportimi i ministrave, shqyrtimi i projektligjit, dëgjimi i kandidatëve për ambasadorë, shqyrtimi i propozimeve për formimin e grupeve të miqësisë e çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Komisionit.

Puhie Demaku, duke u ndërlidhur me draft-planin e punës së Komisionit për vitin 2015, propozoi që të kërkohet Plani dhe Strategjia e MPJ-së për vitin e parë të këtij mandati, në mënyrë që të harmonizohet me planin e Komisionit. Po ashtu, propozoi që ministri i MPJ-së të raportojë çdo tre muaj në Komision, e edhe ministri i MD-së të raportojë më shpesh, të ftohet për raportim ministri i Dialogut me Serbinë, të parashihet një konferencë e ambasadorëve në qershor të këtij viti, të parashihen takime me organizatat që mbështesin punën e Kuvendit, si dhe shtroi çështjen e propozimit të vizitës në Bruksel, se a është ajo e harmonizuar me agjendën e Brukselit.

Ramush Haradinaj, propozoi që me rastin e shqyrtimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, të ftohen edhe sponsoruesit e tyre, në mënyrë që të diskutohen çështjet së bashku dhe të merren vendime sa më të drejta.

Zafir Berisha, lidhur me draft- planin dhe programin e punës së Komisionit, tha se është rrjedhojë e kompetencave të Komisionit sipas Rregullores, ndërsa për raportimet e ministrit të Jashtëm dhe atij të Diasporës, tha se është dashur të parashihen më herët, përkatësisht në muajin shkurt.

Blerta Deliu- Kodra, përkrahu propozimin e deputetes Puhie Demaku, se Komisioni duhet ta ketë Strategjinë e punës së MPJ-së, që ta harmonizojë me planin e Komisionit. Sa i përket propozimit për organizimin e tryezës së organizatorëve, tha se kjo çështje do të mund të konsumohej me mbikëqyrjen e ligjit, ndërsa për raportimin e ministrave në Komision, përveç ministrit të Jashtëm, propozoi të ftohen edhe ai i Integritimit Evropian, i Forcës së Sigurisë, i Kulturës dhe i Zhvillimit Ekonomik. Lidhur me vizitat e Komisionit, propozoi që përveç vizitës së paraparë në Shqipëri, të organizohen fillimisht edhe vizita të tjera në rajon, e më pas të vazhdohet me vizita të tjera.

Enver Hoxhaj, theksoi se Komisioni duhet ta ketë një strategji për bashkëpunim ndërparlamentar, të cilën e kanë parlamentet tjera, strategji që duhet të ketë mision dhe objektiva të qarta. Sipas kësaj strategjie, tha se përveç bashkëpunimit bilateral, duhet operuar edhe në rrafshin multilateral. Një strategji e tillë, do të na mundësonte të kemi një agjendë veprimi për katër vitet e ardhshme. Po ashtu, theksoi se nuk kemi një qasje të plotë e të mirëfilltë se në cilat organizata duhet të anëtarësohet Kuvendi i Kosovës, cilat janë procedurat e anëtarësimit të tij në këto organizata, a është problem mosnjohja e Kosovës për anëtarësim dhe në çfarë forme duhet të veprojmë për anëtarësim gjatë këtij mandati.

Pajtohet me propozimet e deputetëve se përveç ministrit të Punëve të Jashtme, të ftohen për raportim edhe ministri i Forcës së Sigurisë, i Diasporës, i Integritimit Evropian, i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i Zhvillimit Ekonomik dhe ai për dialog.

Puhie Demaku, përkrahu propozimin e kryetarit të Komisionit, për hartimin e një strategjie ndërparlamentare, por për këtë propozim theksoi se Kuvendi duhet të ketë mundësi buxhetore. Ndërsa me rastin e raportimeve të ministrave, vuri në pah mundësinë sipas Rregullores për mbajtjen e takimeve të përbashkëta me komisionet e tjera.

Zafir Berisha, lidhur me bashkëpunimin parlamentar, propozoi që të merren për bazë përvojat e shtetit slloven dhe atij kroat.

Elmi Reçica, në diskutimin e tij, në mes tjerash, tha se e përkrah hartimin e planit dhe programit të punës së Komisionit, si dhe hartimin e Strategjisë ndërparlamentare, duke ndarë prioritetet sipas fuqisë, qasjes dhe ndikimit që kanë.

Cerim Bajrami, përkrahu propozimet lidhur me planin dhe programin e punës së Komisionit dhe propozoi që në fillim të draftit ku përmendet Ministria e Punëve të Jashtme, të shtohet edhe Ministria e Diasporës, pasi që në vazhdim të tekstit kemi raportimin e ministrit të Diasporës.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim draft-planin dhe programin e punës së Komisionit për Punë të Jashtme për vitin 2015.

Në draft- planin dhe programin e punës së Komisionit, të inkorporohen propozimet e anëtarëve të Komisionit dhe më pas drafti me propozimet e inkorporuar, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

4. Formimi i grupeve të miqësisë

Enver Hoxhaj, i njoftoi anëtarët e Komisionit se të gjithë deputetëve të Kuvendit iu është shpërndarë një njoftim lidhur me mundësinë për propozime, për formimin e grupeve të miqësisë, sipas Rregullores për formimin e grupeve të miqësisë të Kuvendit. Bëri të ditur se i është ofruar një material nga protokolli, lidhur me gjendjen aktuale të grupeve të miqësisë në Kuvend, për të cilën, përveç tjerash, tha se ka edhe disa nisma, të cilat nuk kanë mundur të jetësohen. Theksoi se është e nevojshme që anëtarët e Komisionit të kenë një listë me informacione, se me cilat vende është marrë vendim për themelimin e grupeve të miqësisë, me të cilat duhet të vihen kontaktet dhe për cilat shtete, të cilat e kanë njohur Kosovën dhe ato të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, duhet bërë kërkesa konkrete.

Cerim Bajrami, njoftoi se nga GP/6+, është propozuar formimi i Grupit të Miqësisë me Turqinë, por meqë një vendim i tillë ekziston nga legjislatura e mëparshme, theksoi se ai grup mund të reformohet me deputetë nga legjislatura e tanishme, apo mund të hyjë në grup me vendet e tjera sipas ndonjë riorganizimi.

Anëtarët e Komisionit: P. Demaku, R. Haradinaj, Z. Berisha, E. Reçica, B. Deliu- Kodra dhe deputetja e pavarur M. K. -Ukelli, në diskutimet e tyre lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, theksuan të nevojshme që të kenë informata më të hollësishme lidhur me konsolidimin edhe aktivitetet e grupeve të miqësisë të Kosovës, që të bëhet një studim se në cilat vende ekzistojnë grupet e miqësisë me Kosovën dhe të shqyrtohet mundësia e vënies së kontakteve me ta, si dhe diskutuan lidhur me nevojën e organizimit të një punëtorie për formimin e këtyre grupeve, duke pasur parasysh një ndarje gjeografike e përmbajtjesore të tyre.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të kërkohet nga Ministria e Punëve të Jashtme një informatë se, në cilat shtete ekzistojnë grupet e miqësisë dhe të shqyrtohet situata e deritanishme e grupeve të miqësisë në Kuvend.

5. Të ndryshme

Enver Hoxhaj, njoftoi anëtarët se Komisionit i është proceduar një kërkesë, më 19 janar 2015, për thirrje në raportim të ministrit të MPJ-së, të z. Hashim Thaçi, lidhur me situatën e migrimit të qytetarëve të Kosovës. Kërkesa është nënshkruar nga anëtarët e Komisionit: Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Lidhur me kërkesën dhe nevojën e raportimeve në Komision, diskutuan deputetët: Puhie Demaku, Ramush Haradinaj, Elmi Reçica, Margarita Kadriu- Ukelli, Zafir Berisha, Enver Hoxhaj.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisionit nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të ftohen për të raportuar në Komision: ministri i Ministrisë për Punë të Jashtme, ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ministri i Ministrisë së Integrimit Evropian, ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ministri i Ministrisë së Diasporës, ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ministrja për Dialog.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj